

Mbi

Auditimin e Brendshëm

Ushtruar në Drejtorine e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave

Njesia e Auditimit Brendshëm – Bashkia Shkoder bazuar ne ligjin 114/2015 “Per Auditimin e Brendshëm ne sektorin publik”, VKM nr 212 date 30.03.2012 “Per miratimin e kriterëve per ngritjen e Njesive te Auditimit te Brendshëm ne sektorin publik”, zhvilloi nje mison auditimi te plote ne Drejtorine e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave – Bashkia Shkodër, per periudhen 01 .01. 2016 – 31.10.2017 nga auditimi rezultoi:

Permbledhje ekzekutive

Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave - Bashkia Shkodër gjatë auditimit janë konstatuar mangesi ne perpilimin e rregullores brendshme dhe miratimin e saj, nuk jane hartuar plane vjetore, nuk është përpiluar harta e proceseve punës, ka mangesi ne perpilimin e regjistrit të riskut, nuk është bërë plani veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk janë përpiluar liste kontrollet për vizitat në terren.

Nga auditimi ka rezultuar se nuk është kryer studimi për Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit. Nuk është përcaktuar Njësia Përgjegjese e administrimit të pyjeve, nuk eshte hartuar dhe miratuar plani i shfrytëzimit të pyjeve, nuk është ngritur struktura e Policise Pyjore, si dhe nuk është dokumentuar asnjë rast “vendim Kundravajtjet” .

Nga verifikimi i kryerjes së procedurave te shfrytezimit te lendes drusore ka rezultuar se nuk është bërë vlersimi i nevojave të popullates për material drusor, janë përcaktuar sasite e shfrytëzimit materialit drusor, janë miratuar, ndersa per damkimin nuk është përpiluar dokumentacion i realizimit me proces-verbal. Nuk është bërë dorëzimi i ngastrave me proces-verbal si dhe nuk është bërë kolaudimi i ngastrave të shfrytëzuara (sipas ankandit te realizuar ne Janar 2017). Per vitin 2017 nuk janë realizuar procedura të prokurimit publik.

Nga auditimi i kryer rezultoi se nuk eshte bere studim lidhur me mundesine e vendosjes se tarifave nga perdorimi i tokes pyjore dhe pyjeve, nuk eshte bere evidentimi i të gjitha kontratave të lidhura me të tretë , si dhe shlyerja e detyrimit te tyre. Te ardhurat nga perdorimi i tokes pyjore nuk jane administruar dhe menaxhuar nga Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave - Bashkia Shkodër.

GJETJET DHE REKOMANDIMET

1.Gjetje Referuar neneve 4, 5,11 të ligjit nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Anekseve të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdherin e Ministrit Financave nr. 108 datë 17.11.2016, Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave - Bashkia Shkodër, duhej të kishte hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme të funksionimit, përgatitjen e planit vjetor të punës, përpilimin e hartës proceseve të punës, hartimin e regjistrit të riskut, planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, metodologjinë dhe listet kontrollet për vizitat në tërren, planin kontrollit brendshëm, nga auditimi i kryer ka rezultuar se ka mangësi në përpilimin e rregullores brendshme dhe miratimin e saj, nuk janë hartuar plane vjetore, nuk është përpiluar harta e proceseve të punës, ka mangësi në përpilimin e regjistrit të riskut, nuk është plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk janë përpiluar listet kontrollet për vizitat në tërren.

Rekomandime

a. Përshtatjen dhe miratimin e rregullores së funksionimit në përputhje me shembullin 01 të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdherin e Ministrit Financave nr. 108 datë 17.11.2016.

b. Përpilimin e planit vjetor të punës, përmirësimin e regjistrit të riskut, hartimin e planit të veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, përpilimin e listet kontrolleve për vizitat në tërren.

2.Gjetje Në referencë të nenit 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Drejtoria Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave, përpara krijimit të Drejtorisë, duhej të kishte hartuar dhe propozuar kryetares Bashkisë strategjinë e funksionimit të ndermarrjes Shërbimeve pyjore e bujqësore, duhej të kishte përpiluar strategjinë e administrimit të fondit pyjor dhe kullësor publik. Në referencë të pikës nën 3, 8, 12, 16 të Ligjit 48/2016 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” duhej të ishte përcaktuar qarta Njësia Përgjegjëse e administrimit të pyjeve, duhej të ishte miratuar plani i shfrytëzimit të pyjeve, duhej të ishte ngritur struktura e Policisë Pyjore, duhej të ishte dokumentuar rastet e “vendim Kundra vajtje”

Nga auditimi i kryer ka rezultuar se nuk është kryer studimi për Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit. Nuk është përcaktuar Njësia Përgjegjëse e administrimit të pyjeve, nuk është hartuar dhe miratuar plani i shfrytëzimit të pyjeve, nuk është ngritur struktura e Policisë Pyjore, si dhe nuk është dokumentuar asnjë rast “vendim Kundra vajtjet” .

Rekomandime

a. Të përpilohet strategjia e administrimit të fondit pyjor, kullësor dhe administrimit të ujërave dhe të dërgohet për miratim pranë Kryetares Bashkisë Shkodër.

b. Të bëhet propozimi për përcaktimin e përgjegjësisë për Drejtorinë e shërbimeve Bujqësore e pyjore për administrimin e pyjeve e kullotave.

c. Të bëhet propozimi për Përcaktimin e Njesisë Përgjegjëse për administrimin e pyjeve, si dhe për ngritjen e strukturës së policisë Pyjore.

3.Gjetje Në referencë të pikës 6, V.K.M nr. 438 datë 08.06.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore” brenda datës 30 Prill 2017 duhej të ishte bërë vlerësimi i nevojave për material drusor, brenda mundësive të shfrytëzimit të pyjeve dhe të dërgohej për miratim.

Sipas pikës 16, në periudhën 15 Maj -15 korrik, duhej të ishte bërë dëmtimi i dryreve që do të priten. Sipas pikës 5 shfrytëzimi i pyjeve lejohet nga data 1 Tetor deri me datë 30 shtator të vitit pasardhës dhe në këto kushte nga data 15 Korrik deri me 1 tetor 2017, duhej të ishte kryer procedura e përgatitjes së dokumentacionit, kryerjes së procedurave të prokurimit publik, lidhjes së kontratës dhe dorëzimit të ngastrave për shfrytëzim. Sipas pikave 20-21 duhej të ishte bërë dorëzimi i ngastrave me proces verbal dhe në fund të shfrytëzimit të bëhej kolaudimi i shfrytëzimit. Nga verifikimi i procedurave të kryera ka rezultuar se nuk është bërë vlerësimi i nevojave të popullatës për material drusor, janë përcaktuar sasia e shfrytëzimit të materialit drusor, janë miratuar, ndërsa për dëmtimin nuk është përpiluar dokumentacioni i realizimit me proces-verbal. Nuk është bërë dorëzimi i ngastrave me proces-verbal si dhe nuk është bërë kolaudimi i ngastrave të shfrytëzuara (sipas ankandit të realizuar në Janar 2017) Për vitin 2017 nuk janë realizuar procedurat e prokurimit publik.

Rekomandim

a. Brenda datës 30 Prill 2018 të përpilohet plani i nevojave të popullatës dhe mundësia e shfrytëzimit të pyjeve, me pas të bëhet miratimi pranë ministrisë përgjegjëse.

b. Në periudhën 15 Maj – 15 Korrik të bëhet identifikimi dhe dëmtimi i druveve për shfrytëzim, dëmtimi të justifikohet me dokumentacion ligjor.

c. Në periudhën 15 Korrik- 15 Gusht të hartohet dokumentacioni tekniko-ligjor i prokurimit publik.

d. Në periudhën 15 Gusht- 15 Shtator të kryhen procedurat e prokurimit.

e. Pas kontraktimit të bëhet dorëzimi i ngastrave me proces verbal të vecantë.

f. Pas përfundimit të shfrytëzimit të bëhet kolaudimi i shfrytëzimit ngastrave.

g. Të krijohet infrastruktura e nevojshme e shitjes së materialit drusor, ku fillimisht të bëhet furnizimi i institucioneve publike, veçanërisht institucionet në vartësi të bashkisë, për të bërë të mundur eliminimin e prokurimeve për material drusor të këtyre të fundit.

h. Per vitin 2018 te behet planifikim per pajisje me bazë logjistike dhe uniforma te personelit pyjor.

4.Gjetje. Referuar neneve 9, 23,24, të ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”, duhej te ishte kryer informimi i organeve eprore si dhe duhej te ishte ngritur sistemi i monitorimit,ndersa nëpunesi autorizues nuk ka informuar me shkrim te pakten ne fund te vitit ushtrimor lidhur me funksionimin e kontrollit te brendeshem, duke vepruar ne kundërshtim me nenin 9, ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Rekomandim Të përcaktohet në rregullore, monitorimi dhe raportimi, në fund te vitit ushtrimor te informohet me shkrim Kryetare e Bashkisë për të gjithë aktivitetin e kryer gjate vitit.

5.Gjetje Ne reference te kreut III, pikat 1,2 të V.K.M nr. 510, datë 10.6.2015 PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN E TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE, PERSONELIT, AKTIVEVE TË TRUPËZUARA DHE TË PATRUPËZUARA, TË ARKIVAVE DHE ÇDO DOKUMENTACIONI TJETËR ZYRTAR NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE, TË PREKURA NGA RIORGANIZIMI ADMINISTRATIVOTERRITORIA” duhej te ishte bere ndjekja e kontratave te lidhura nga ish komunat Pjese te Bashkisë Shkodër, nga auditimi I kryer rezultoi se kontrata e lidhur per dhenie ne perdorim te tokes per vendosje antena në njesinë pyjore, mbi lumin shale fshati Nenmavriq nuk është evidentuar dhe ndjekur detyrimet per vlere 2.200.000 lek , ky veprim perben shkelje te disipline financiare me dëm efektiv.

Rekomandime

a. Në bashkëpunim me Drejtorine e të Ardhurave të bëhet një studim lidhur me mundesine e vendosjes tarifave nga perdorimi i tokes pyjore dhe pyjeve, të bëhet evidentimi i të gjitha kontratave të lidhura me të tretë si dhe të kerkohet ne rruge ligjore shlyerja e detyrimit.

b. Te behet verifikimi i plote i detyrimeve per hidrocentralin e ndertuar mbi lumin Shale.

c. Te mbahen akt-rakordime me drejtorine e te Ardhurave çdo muaj per arketimin e tarifave pyjore sipas llojit arketimit.

Njesia Auditimit Brendshem

Bashkia SHKODER

